



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 57/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tasnjëri Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përmbaruesi privat, z. _____ dhe pala ankuese z. _____ përfaqësues i _____ me seli në _____ dhe pas seances keshillimore, me datën 27.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL. Nr. 57/2021, dt 06.12.2021 si dhe ankesa e pala ankuese z. _____ përfaqësues i _____ me seli në _____ dt 01.12.2021, si të pabazuara.

A R S Y E T I M

Me datën 01.12.2021, pala ankuese z. _____ përfaqësues i _____ me seli në _____ ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira, Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. _____. Pala ankuese pretendon që me datën 12.02.2018 është paraqitur propozim për përmbarim nga pala kreditore _____ Regjioni _____ Njësia Operative Rahovec kundër palës debitore _____ "Kozmetik" pa numër biznesi. Sipas palës ankuese në propozim është shënuar emri i palës debitore që nuk është regjistruar në _____ kurse është zbatuar procedura përmbarimore ndaj një biznesi jo të saktë. Pala ankuese thekson që i janë tërhequr mjetet nga llogaria ende pa pranuar propozimin apo faturë për pagesë kur dihet se fatura si dokument i besueshëm duhet të jetë i nënshkruar nga kreditori dhe debitori. Po ashtu, pala ankuese pretendon që përmbaruesi privat i ka keqpërdorur mjetet e palës debitore sepse në llogari kishte mjete të mjaftueshme për përfundimin e lëndës pa pasur nevojë të bllokimit të automjetit dhe shkaktimit të shpenzimeve shtesë, siç janë paraqitur në pasqyrën e shpenzimeve. Rrjedhimisht, pala ankuese

pretendon se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me nenet 9, 331 dhe nenin 342, të LPP-së.

Me datën 06.12.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, pas shqyrtimit të çështjes ka paraqitur në Komisionin Disiplinor Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat z. [] si organ përmbarues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën P. nr 58/2018.

Përmbaruesi privat z. [] në përgjigjen e tij me shkrim thekson që sipas propozimit të palës kreditore, me urdhrin përmbarimor P. nr 58/18, të dt 15.02.2018, është lejuar përmbarimi ndaj palës debitore [] Sipas përmbaruesit privat, propozimit i ishte bashkangjitur deklarata per arritshmërinë e kërkesës për borxhin prej 394.92 euro dhe kartela e konsumatorit për borxhin e kërkuar. Propozimi për përmbarim, thekson përmbaruesi privat, i është dorëzuar debitorit përmes rrugës postare në adresën si në propozim me dt 24.02.2018. Nga fletë kthesa rezulton se është nënshkruar nga pala debitore personalisht e po ashtu edhe dorëzuesi i postës. Rrjedhimisht, përmbaruesi privat pretendon që urdhri për lejimin e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore është bërë i formës së prerë me dt 05.03.2018. Pas sigurimit të numrit personal të palës debitore, përmbaruesi privat thekson që ka urdhëruar bllokimi i llogarive bankare me datën 16.04.2018. Përmes konkluzionit të datës 25.10.2018, është ftuar pala debitore që të paraqitet për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve. Konkluzioni i është përcjellë debitorit në adresën e tij personale por shkresat janë refuzuar personalisht nga pala sipas konfirmimit nga zarfi i kthyer me konstatimin "*refuzim i pranimit të shkresave.*" Rrjedhimisht, përmbarimi, sipas përmbaruesit privat z. [] ka vazhduar me sekuestrimin e mjeteve nga llogaria personale e palës debitore dhe nga mjetet e tij në llogari personale. Megjithatë, duke qenë se ka pasur pengesa në përmblylljen e përmbarimit nga mungesa e mjeteve, është vendosur ndalesa në regjistrimin dhe tjetërsimin e automjetit. Pas realizimit të përmbarimit, janë liruar llogaritë, është hequr ndalesa për regjistrimin e automjeteve, është punuar pasqyra e shpenzimeve dhe është nxjerrë urdhri për përfundimin e lëndës.

Me datën 27.01.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, përmbaruesi privat, z. []

dhe pala ankuese z. [] përfaqësues i [] me seli në Rahovec. Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e Raportit Përfundimtar duke theksuar se mbetet pranë të njëjtës. Po ashtu, përmbaruesi privat dhe ankuesi kanë ngelur pranë ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitura me shkrim dhe kanë bërë eleborimin e tyre.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat z. [] nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Komisioni Disiplinor gjen se pala ankuese nuk ka arritur të provojë që përmbaruesi privat z. [] me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore në lëndën përmbarimore P. nr 58/2018, ka kryer shkeljet e pretenduara disiplinore nga neni 9, 331 dhe nenin 342, të LPP-së. Është e rëndësishme të theksohet fillimisht që kompanitë të cilat ofrojnë shërbime publike, në këtë rast, Kompania [] Regjioni [] Njësia Operative Rahovec,

është aty për të ofruar shërbimet e pastrimit për gjithë qytetarët e qytetit të Në ofrimin e shërbimeve publike kualitative, mes tjerash, mjetet financiare janë të veçanërisht të rëndësishme për kompaninë. Rrjedhimisht, përveç që qytetarët duhet të përmbushin detyrimet e tyre, është e rëndësishme që detyrimet të përmbushen me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Në rastin konkret, pala ankuese, siç deklaroi edhe vet gjatë seancës dëgjimore, asnjëherë nuk ka bërë pagesë për shërbimet e kompanisë. I njëjti pretendon që të dhënat në propozimin për përmbarim, respektivisht urdhrin për përmbarim nuk janë të sakta. Të dhënat, megjithatë, janë të sakta edhe pse ato, në një masë, mund të mos jenë krejtësisht të plota. Me një fjalë, ato janë mjaftueshëm konkrete për të përcaktuar palën debitore. Urdhri përmbarimor përmban të dhënat si emrin, mbiemrin, selinë e biznesit, rrugën etj. Pala kreditore i kishte bashkangjitur Propozimit deklaratën për arritshmërinë e kërkesës për borxhin prej 394.92 euro dhe kartelën e konsumatorit për borxhin e kërkuar, të cilat janë në shkresat e lëndës. Përmbaruesi privat z. kishte ndërmarrë veprimet bazuar në të dhënat e ofruara nga pala kreditore Regjioni - Njësia Operative Përmbaruesi privat i ka ofruar debitorit shkresat e lëndës, dhe pala debitore kishte mundësinë t'i sfidonte veprimet e përmbaruesit privat në gjykatë përmes shfrytëzimit të mjeteve juridike. Komisioni Disiplinor nuk gjen asnjë provë se obligimi për pagesën e shërbimeve lidhet me ndonjë person tjetër fizik apo juridik. Përkundrazi, kartela e konsumatorit lidhet me palën debitore, këtu palën ankuese. Po ashtu, në shkresat e lëndës është edhe deklarata e z. inkasant në Eko Regjioni - Njësia Operative i cili konfirmon që klient është z. i cili është pronar i biznesit mbi të cilin bie detyrimi. Foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës në mënyrë vizuale pasqyron biznesin të cilin udhëheq debitori - këtu pala ankuese z. e së cilit i ngarkohet detyrimi. Thiesht, pala ankuese përpiqet t'i shmangët detyrimin. Rrjedhimisht, përmbaruesi privat z. nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Për sa i përket pretendimeve tjera se përmbaruesi privat z. në mënyrë të kundërligjshme ka keqpërdor mjetet e palës debitore sepse në llogari kishte mjete të mjaftueshme për përfundimin e lëndës pa pasur nevojë të bllokimit të automjetit dhe shkaktimit të shpenzimeve shtesë, Komisioni Disiplinor gjen pretendimin e palës ankuese të pabazuar. Përmbaruesi privat z. kishte ndërmarr veprimet përmbarimore në bllokimin e llogarisë personale të palës debitore e jo llogarisë së biznesit. Pala debitore nuk kishte mjete të mjaftueshme në llogarinë e tij bankare për përmbushjen e detyrimit. Rrjedhimisht përmbaruesi privat ishte i obliguar të ndërmarr veprimet tjera për realizimin e përmbarimit në mënyrë të plotë. Pas realizimit të përmbarimit, përmbaruesi privat kishte liruar llogarinë bankare, është hequr ndalesa për regjistrimin e automjeteve, është punuar pasqyra e shpenzimeve dhe është nxjerrë urdhri për përfundimin e lëndës. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, përmbaruesi privat z. ka vepruar në pajtim me dispozitat e LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 57/2021, datë 27.01.2022

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

Handwritten header text, possibly a title or address, located at the top of the page.

A horizontal line or separator line across the page.

Main body of handwritten text, consisting of several paragraphs of cursive script.

Second section of handwritten text, appearing as a separate paragraph or entry.

Text located below the second main paragraph, possibly a signature or note.

Text at the bottom of the page, including a circular stamp or seal on the left side.

